



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Administrimi Publik (2012/2013)**

Fakulteti	Shkencat Shoqërore Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180
Titulli	I diplomuar në administrim publik
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-671/2
Data akreditimit	22.06.2012

Përshkrimi i programit

Programi i Administratës publike ka një qasje multidisiplinare të elementeve kryesore të studimit në fushën e Administratës publike dhe menaxhimit, të drejtës, shkencave socio-ekonomike, i përshkruan dhe identifikon konceptet themelore, parimet, proceset administrative dhe ligjore, teoritë në administrimin publik, siç janë janësjetë njerëzore dhe institucionale, procesi i politikave publike, ekonomia e sektorit publik dhe menaxhimi i organizatave publike dhe jo fitimprurëse.

Qëllimet kryesore të programit janë t'i përgatitin studentët për:

- Përgatitje të dokumenteve administrative, planifikim dhe koordinim të punës ndërinstitucionale, arkivim, regjistrim të lëndëve administrative përmes përdorimit të sistemit të informacionit.
- Aplikim të njohurive profesionale në përmbushjen e detyrave në institucionet shtetërore dhe në administratën publike, në organizatat private dhe shoqërinë civile.
- Të zhvillojnë të menduarit kritik në lidhje me punën në institucionet shtetërore dhe ato publike në rast të shkeljes së rregullave administrative, burokracisë dhe jotransparencës.
- Të jenë të aftë në mënyrë analitike të zhvillojnë rolin e administratës publike dhe shtetërore në dekadat e fundit në Republikën e Maqedonisë dhe në shtetet në rajon.
- Të njohin trendet bashkëkohore dhe veprimet e shtetit në institucionet publike dhe menaxhimin publik në vendet në zhvillim dhe ato të zhvilluara.
- Të jenë në gjendje të marrin iniciativë për identifikimin dhe adresimin e nevojave për mësim për institucionet shtetërore dhe administratën publike.

Karriera

Studimet e Administrimit Publik mundësojnë plotësimin e nevojave arsimore në përkrahjen e studentëve në fillimin e karrierës së tyre profesionale në agjencitë qeveritare në nivel qendror dhe lokal, komunat, institucionet publike, administratën e shkollave, organizatat jo fitimprurëse, universitetet dhe ndërmarrjet.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Fitoni njohuri multidisiplinare dhe të kuptuarit të elementeve kryesore të studimit në fushën e administrimit publik dhe

menaxhimit, të drejtës, shkencave socio-ekonomike.

- Përshkruan dhe identifikon konceptet themelore, parimet, proceset administrative dhe ligjore, teoritë në administrimin publik, siç janë ato lidhur me sjelljen njerëzore dhe institucionale, procesin e politikave publike, ekonominë e sektorit publik dhe menaxhimin e organizatave jofitimprurëse.
- Kupton sistemet e ndryshme të administrimit publik- administrimit shtetëror, menaxhimin publik dhe ndërveprimin e institucioneve politike dhe proceset, politikat qeveritare dhe administrative.
- Ka njohuri rreth proceseve të integritetit në Bashkimin Evropian nga administrimi publik dhe shtetëror dhe aspektet institucionale.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Praktikë lidhur me punën komplekse në administratën shtetërore dhe publike si dhe të zbatojë rregullat dhe procedurat adekuate.
- Mund të demonstrojë aftësi për të përgatitur dokumente administrative, të ndihmojë në planifikimin dhe koordinimin e punës ndër-institucionale, arkivimin, regjistrimin e lëndëve administrative përmes përdorimit të sistemit të informacionit.
- Mund t'i aplikojë njohuritë profesionale në përmbushjen e detyrave në institucionet shtetërore dhe publike, organizatat private dhe shoqërisë civile.

Aftësitë për të vlerësuar

- Është në gjendje të dallojë karakteristikat dhe trendet aktuale në institucionet shtetërore dhe ato publike, në organizatat private dhe organizatat joqeveritare në vend.
- Të zhvillojë të menduarit kritik në lidhje me punën në institucionet shtetërore dhe ato publike në rast të shkeljes së rregullave administrative, burokracisë dhe jotransparencës.
- Të vlerësojë strukturat dhe proceset e ndryshme të menaxhimit të sektorit publik, këshllimin dhe kontrollin.
- Të krahasojë në mënyrë kritike zhvillimin e rolit të shtetit dhe të administrimit publik në dekadat e fundit në Maqedoni dhe rajon.

Aftësitë e komunikimit

- Të jetë në gjendje të flasë dhe të shkruaj në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze në përputhje me protokollet dhe rregullat që kanë të bëjnë me administratën publike.
- Të mund të përdorë mjete të ndryshme të komunikimit dhe të respektojë standardet etike gjatë punës në institucionet shtetërore dhe si faktor publik.
- Të mund të veprojë në mënyrë të pavarur dhe të koordinohet me të tjerët me qëllim të përmbushjes së detyrave të ndryshme në nivele klerarkike.
- Të sqarojë rolet ndërpersonale dhe ndërorganizative të individëve në kuadër të shërbimit publik.

Aftësitë e të mësuarit

- Njeh trendet bashkëkohore dhe veprimet në shtet dhe në institucionet publike dhe menaxhimin publik në vendet në zhvillim dhe ato të zhvilluara.
- Mund të aplikojë një mënyrë të re transparente të punës në administratën shtetërore dhe publike duke përdorur mjete të reja teknologjike.
- Mund të ndërmarrë iniciativë për identifikimin dhe adresimin e nevojave mësimore për institucionet shtetërore dhe administratën publike.
- Aftësi për mësim të përhershëm dhe vetëmësim në fushën e administrimit publik.
- Ka aftësi për të propozuar plan dhe të kryejë trajnime për personët e sektorit të administratës dhe institucioneve publike.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [6.0 SETK] **Fillet e së drejtës**
- [6.0 SETK] **Bazat e ekonomisë**
- [6.0 SETK] **Hyrje në administrimin publik**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore nga Gjuha Angleze1**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore nga Gjuha Shqipe/Maqedonase 1**

- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore e lirë 1

Semestri 2

- [6.0 SETK] Parimet e sociologjisë
- [6.0 SETK] E drejta kushtetuese
- [6.0 SETK] Lidërshipi publik dhe zhvillimi organizativ
- [3.0 SETK] Lëndë zgjedhore nga Gjuha Angleze2
- [3.0 SETK] Lëndë zgjedhore nga Gjuha Shqipe/Maqedonase 2
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore e lirë 2

Semestri 3

- [6.0 SETK] Bazat e statistikës
- [6.0 SETK] Hyrje në politikat publike
- [6.0 SETK] E drejta administrative
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore e lirë 3
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore nga Gjuha Angleze për qëllime specifike 1

Semestri 4

- [6.0 SETK] Institucionet dhe politikat e BE-së
- [6.0 SETK] Procedura administrative
- [6.0 SETK] Menaxhimi me burimet njerëzore në sektorin publik
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore nga Gjuga Angleze për qëllime specifike 2/ ose Lëndë zgjedhore 4/1
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore 4/2

Semestri 5

- [6.0 SETK] Financat Publike
- [6.0 SETK] Sistemet e vetëqeverisjes lokale
- [6.0 SETK] Konceptet dhe parimet bashkëkohore të menaxhimit në sektorin publik
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore 5/1/1
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore 5/2/1

Semestri 6

- [6.0 SETK] Administrimi publik krahasues
- [6.0 SETK] Puna në zyrë
- [6.0 SETK] Analizat kuantitative dhe kualitative në sektorin publik
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore 6/1/1
- [6.0 SETK] Lëndë zgjedhore 6/2/1

Description of courses

Lëndë obligative

- **Fillet e së drejtës**

Fillet e së drejtës përdor njohuritë, konceptet dhe kategoritë themelore nga disipinat e tjera të së drejtës dhe ka për detyrë studentëve 'u japë njohuri themelore, të përgjithshme dhe hyrëse lidhur me shtetin dhe të drejtën.

- **Bazat e ekonomisë**

Lënda është dizajnuar me qëllim që studentët të njihen me mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm të ndërmarrjes. Megjithatë, vëmendje do t'i kushtohet funksionit të financimit, marketingut dhe atij organizativ të ndërmarrjes. Përveç kësaj, analizohet ndikimi i ndërmarrjes në rrethinën ku ajo vepron.

- **Hyrje në administrimin publik**

Administrata publike paraqet një fushë të veçantë të interesit shkencor. Lënda: Hyrje në administrimin publike duhet tu ofrojë studentëve njohuri bazike mbi konceptet themelore të administratës publike. Vëmendje e posaçme do t'i

kushtohet ofrimin të njohurive për evoluimin e administratës publike, si dhe reformat e parapara të administratës publike në vendin tonë. Gjithashtu, studentët do të kenë mundësi që të njoftohen dhe në mënyrë kritike të analizojnë zhvillimin dhe fenomenet në administratën publike. Pasi që lëmi e studimit është objekt i ndryshimit të pandërprerë, vëmendje e posaçme do t'i kushtohet zhvillimeve të reja si dhe teorive klasike të studimit të administratës publike. Materia hulumtuese e kësaj lënde konsiston në: përkufizimet dhe njohuritë themelore për parimet dhe institucionet e administratës publike, rolin dhe rëndësinë e administratës publike në shoqërinë e organizuar, gjenezën dhe zhvillimin historik të administratës publike, strukturat organizative të administratës publike, funksionimi i institucioneve të administratës publik, shërbimet e administratës publike, vendimmarrjen në AP, administrata publike si shërbim për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut, reformat e administratës publike në Maqedoni etj.

- **Parimet e sociologjisë**

Lënda "Parimet e sociologjisë" ka për qëllim të përgatisë studentët me njohuri të përgjithshme rreth fenomeneve sociale si dhe me njohuri të veçanta dhe specifike rreth proceseve dhe fenomeneve shoqërore me të cilat ata përballen dhe do të përballen në të ardhmen si qytetarë dhe akademikë.

- **E drejta kushtetuese**

Studentët përfitojnë njohuri teorike dhe praktike nga e drejta kushtetuese si degë themelore e së drejtës, nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik dhe politik i shtetit si dhe nga kushtetushmëria dhe ligjshmëria si parime bazë të shtetit juridik.

- **Lidershipi publik dhe zhvillimi organizativ**

Lënda ka për qëllim të njoftojë studentët me mënyrën se si liderët dhe udhëheqësit e zhvillojnë dhe zbatojnë arritjet e misionit dhe vizionit në një organizatë të dhënë në sektorin publik; zhvillimin e vlerave të nevojshme për sukses afatgjatë dhe zbatimin e tyre nëpërmjet aktiviteteve dhe shprehive të përshtatshme; si liderët dhe udhëheqësit janë personalisht të përfshirë në sigurimin që sistemet e menaxhimit të sigurisë do të zhvillohen dhe zbatohen. Gjithashtu i njofton për mënyrën se si organizata e realizon misionin dhe vizionin e saj përmes një strategjie të qartë të bazuar në pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara, të mbështetur nga të gjitha politikatat relevante, planet, qëllimet dhe proceset.

- **Bazat e statistikës**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që t'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri themelore të metodave themelore statistikore dhe zbatimin e tyre me qëllim që të ndjekin literaturën profesionale, që të mund në mënyrë koncize të paraqiten rezultatet dhe përfundimet e hulumtimit të bërë. Aspektet kryesore të studimit të kësaj lënde janë: përcaktimi i disiplinave, lidhja e të dhënave, analiza statistikore, zbatimi i metodave statistikore në fushën e shkencave humane, demonstrimi i të dhënave statistikore dhe lidhshmëria e statistikës me shkencat tjera.

- **Hyrje në politikat publike**

Lënda ka për qëllim t'u mundësojë studentëve t'i kuptojnë më lehtë politikat publike, parimet për krijimin e tyre, udhëheqjen e një politike konkrete, analizën, implementimin, vlerësimin dhe zhvillimin e saj. Menaxhimi i politikave publike është një disiplinë për zgjidhjen e problemeve të cilat rezultojnë në njohuri nga metodologjitë dhe teoritë themelore të shkencave sociale, të profesioneve sociale dhe të filozofisë së politikave.

- **E drejta administrative**

Qëllimi kryesor i lëndës e drejta administrative është të mësuarit e materialit që më mirë dhe më lehtë të kuptohet organizimi dhe funksionimi i administrimit në aspektin kombëtar dhe ndërkombëtar. Njohje më e mirë e akteve ligjore, llojeve të akteve ose metodologjisë për krijimin e mjeteve dhe instrumenteve për kontrollin e administratës.

- **Institucionet dhe politikat e BE-së**

Kjo lëndë ka për qëllim të njoftojë studentët me natyrën komplekse të fenomeneve që përbëjnë integrimin evropian, institucionet dhe politikat. Pjesa e parë e këtij moduli mbulon zhvillimin e institucioneve, procesin e sjelljes së vendimeve dhe rolin e aktorëve kryesorë, ndërsa pjesa e dytë mbulon politikat e BE-së. Gjithashtu, kjo lëndë ka për qëllim të njoftojë studentët me interpretimet kryesore teorike dhe zhvillimin e BE-së, si dhe të marrë në konsideratë sfidat aktuale dhe të ardhshme me të cilat përballen BE në kuadër të institucioneve dhe politikave të saj.

- **Procedura administrative**

Në lëndën proceduara administrative studentët do të fitojnë njohuri lidhur me karakteristikat themelore të legjislacionit pozitiv për procedurën e përgjithshme administrative në Republikën e Maqedonisë si dhe në procedurat

e veçanta të cilat zhvillohen në organet kompetente, si e drejta formale, por edhe nga aspekti krahasues me vendet tjera e veçanërisht atyre të rajonit.

- **Menaxhimi me burimet njerëzore në sektorin publik**

Menaxhimi i burimeve njerëzore (MBNJ) është një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit organizativ. Kjo lëndë fokusohet në shprehje të shumta të menaxhimit të burimeve njerëzore në sektorin publik. Nëpërmjet kësaj lënde do të shqyrtohen teoritë dhe praktikatat e MBNJ në kontekstin e faktorëve, të demokratizimit shoqërisë, zhvillimit të shpejtë të teknologjisë dhe globalizimit që drejtëpërdrejtë ndikojnë në zhvillimin e MBNJ. Njëkohësisht mbikëqyr rolin e MBNJ në organizata me theks të rekrutimit, seleksionimit dhe testimit, trajnimit, zhvillimit dhe kompensimit të burimeve njerëzore në organizatë. Gjithashtu aktivitetet e rëndësishme të MBNJ përfshijnë analizën dhe përshkrimin e vendeve të punës. Të menduarit strategjik gjatë analizës së sfidave organizative dhe kadrovike u ofron zgjidhje konkrete udhëheqësve të sektorit publik. Kjo lëndë ju përgatit të jeni menaxherë të suksesshëm duke ekzaminuar teoritë, praktikatat dhe politikatat bashkëkohore të MBNJ.

- **Financat Publike**

* Studentëve u sigurohet njohuri lidhur me financat publike, si një nga rolet kryesore të politikave makroekonomike dhe instrumenteve themelore për funksionimin e një ekonomie kombëtare si një tërësi dhe si një nënsistem i një sistemi ekonomik të vendit. * Njoftohen me njohuri për të mirat publike dhe shpenzimet, alokimin dhe rialokimin e të hyrave, aspektet krahasuese të financave publike në vendet e zhvilluara dhe atyre të tranzicionit, specifikat e sistemeve fiskale në Maqedoni, trendet dhe sfidat e të njëjtave, decentralizimi fiskal etj. * Njoftohen me njohuri profesionale lidhur me buxhetin dhe fondet jashtëbuxhetore si instrumente kryesore të politikës fiskale, procedurave rreth përgatitjes, përpunimit, përmbledhjes, miratimit, krahasimit dhe kontrollit të buxhetit, si dhe teknikave të buxhetit si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror. * Krijohet një pasqyrë e qartë për studentët lidhur me funksionimin e një sistemi fiskal të dhënë, duke u dhënë pikat e referimit për sa i përket teorive të ndryshme fiskale me të cilat do të mund realizojnë ndryshimet krahasuese dhe të gjejnë pikat e përbashkëta të funksionimit të këtyre sistemeve në vendet e ndryshme. * Marrin njohuri informative për treguesit kryesorë të politikës fiskale në RM, krijohet një bazë reale e të dhënave në aspekt të trendeve fiskale afatgjata në RM duke stimuluar studentët të punojnë punime seminarike dhe ese të pavarura në fushën fiskale.

- **Sistemet e vetëqeverisjes lokale**

Studentët e Fakultetit të administrimit publik dhe Shkencave politike duhet të zotërojnë aftësi themelore madje edhe më të thella lidhur me organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale. Po ashtu duhet të njihen me marrëdhëniet e pushtetit lokal dhe qendror dhe parimet bazë të vetëqeverisjes lokale në shtetet me vetëqeverisje lokale tradicionale, në shtetet e Evropës Juglindore dhe në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi i studimit të kësaj lënde është studentët të jenë të përgatitur në nivelin e duhur që të mund të kryejnë obligimet tërësisht dhe me përgjegjësi.

- **Konceptet dhe parimet bashkëkohore të menaxhimit në sektorin publik**

Studentët do të mund të njihen me aspektet fundamentale të menaxhimit publik si një fushë shkencore dhe si profesion si dhe të analizojnë aktivitetet e qeverisë nga perspektiva e së drejtës, menaxheriale dhe politike.

- **Administrimi publik krahasues**

Qëllimet e programit të kësaj lënde janë që studentët: * Të fitojnë njohuri lidhur me strukturat dhe funksionet e administrimit publik në shtete të ndryshme; * Të fitojnë njohuri lidhur me lëvizjet e reformave globale në fushën e administrimit publik; * T'u mundësohet studentëve që në mënyrë aktive të kyçen në ligjërata dhe të realizojnë hulumtime të pavarura në fushën e administrimit publik për të cilat nuk kanë pasur njohuri paraprake; * Të njihen me reformat e administrimit publik, të cilat paraqesin parakusht për anëtarësimin e vendit tonë në BE; * T'u mëndësohet zhvillimi i qasjes kritike për të analizuar dukuritë në administrimin publik; * Të zhvillojnë aftësitë personale, aftësitë e komunikimit, hulumtimit dhe aftësitë e tjera të nevojshme për një karrierë të suksesshme në administrimin publik.

- **Puna në zyrë**

Studentët e Fakultetit të administrimit publik dhe Shkencave politike duhet të zotërojnë njohuri themelore lidhur me organizimin dhe funksionimin efikas të punës në zyrë në organet shtetërore, ato lokale dhe institucionet e ndryshme dhe ndërmarrjet. Qëllimi i studimit të kësaj lënde është që studentët të përgatiten në nivelin e duhur që të mund të realizojnë detyrimet në mënyrë efikase dhe me përgjegjësi. Njohuritë e fituara nga kjo lëndë do t'u mundësojnë studentëve që më lehtë të mësojnë detyrat e punës në administratën publike.

- **Analizat kuantitative dhe kualitative në sektorin publik**

Qëllimi i kësaj lënde është të përqëndrohet në dy qasjet e përgjithshme në analizën e të dhënave, në ate sasiore dhe cilësore. Në aspektin e analizës kuantitative (sasiore) fokusohet në përdorimin e analizës statistikore ndërsa në aspektin e analizës kualitative (cilësore) definohet si qasjet që nuk përfshijnë qasjet kuantitative ose qasjet të cilat nuk përdorin manipulime numerike. Po ashtu kjo lëndë do t'i analizojë edhe nëpërmes rasteve të studimit dhe do t'i prezantojë metodat e hulumtimit, pjesë të hulumtimeve shkencore sociale, qasjet e dizajnit hulumtues, zbatimet empirike si dhe analizën multivariable.

Lëndë zgjedhore

- **Ekonomia e punës dhe sociale**

Kjo lëndë fokusohet në ekonominë e tregut të punës. I mbulon përcaktuesit e kërkesës dhe ofertës të tregut të punës, përcaktuesit e pagave, dallimet e pagave në mes të grupeve, investimet në kapitalin njerëzor, punësimin dhe papunësinë. Qëllimi i këtij moduli është të punohet me raste studimi lidhur me tregun e punës në vendet e tranzicionit. Përmes ligjëratave dhe ushtrimeve studentët do të njoftohen me drejtimet kryesore të tregut të punës si dhe të fitojnë njohuri për hulumtime origjinale në këtë fushë.

- **Globalizimi si fenomen i shoqërive bashkëkohore**

Objektivat e programit mësimor (kompetencat): * Të kenë një kuptim të thellë konceptual për globalizimin si fenomen që rrafshon botën (Fridman). * Të kenë një vizion për veten dhe shoqërinë në kushtet e globalizimit. * Aftësi për të debatuar në mënyrë inteligjente për globalizimin në dimensione të ndryshme: ekonomike, politike, kulturore, socio-hapësinore. * Të jenë të aftë për të identifikuar sfondin e globalizimit dhe reflekset problematike (p.sh antiglobalizimin). * Të jenë të gatshëm për të krahasuar perspektiva të ndryshme të globalizimit dhe ndikimet e tij në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. * Të kenë mundësi për të zhvilluar një studim të strukturuar të “produktit” ose (epi) fenomenit të globalizimit.

- **Nomoteknika**

Qëllimet e lëndës janë që studentët të aftësohen për krijimin e akteve ligjore, pra për krijimin e së drejtës si dhe rolin e teknikës ligjore në këtë proces në nivel kombëtar, në vendet e tjera dhe nga aspekti krahasues, veçanërisht të së drejtës së Bashkimit Evropian.

- **E drejta ndërkombëtare Evropiane**

Qëllimi i lëndës është që studentët të marrin njohuri rreth ligjit dhe çështjeve themelore të së drejtës ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian në veçanti. Këtu po ashtu trajtohen çështje të burimeve të së drejtës ndërkombëtare, sistemi juridik i një vendi, raporti i sistemit juridik ndërkombëtar me të drejtën e një shteti apo praktikën e tij. Njohuritë themelore që studenti merr në këtë lëndë, nuk është qëllimi që ai vetëm të dijë disa të dhëna të së drejtës ndërkombëtare, por gjithashtu edhe aplikimin e tyre në praktikën e vendit në Maqedoni. Në kohën që po jetojmë e drejta ndërkombëtare dhe ajo e BE-së përbën të drejtën nacionale të vendeve, ajo është pjesë e pandashme e organizatave dhe individëve në përgjithësi.

- **Historia e civilizimit**

Në këtë lëndë studentët gjatë një semestri do të njihen me zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë njerëzore si dhe zhvillimin e civilizimeve duke filluar nga civilizimet e lashta e gjer tek ato më të fundit. Gjithashtu studentët do të njihen me civilizimet më të rëndësishme në botë, dallimet në mes këtyre civilizimeve si dhe përfitimet për përparimin e civilizimeve në jetën shoqërore dhe publike.

- **Partitë politike dhe modelet zgjedhore**

Partitë politike janë subjekt themelor i jetës demokratike në çdo shoqëri bashkëkohore. Modelet zgjedhore janë komponentë më e rëndësishme e çdo sistemi politik, kështu që kjo lëndë ka rëndësi të veçantë për të fituar njohuri të cilat studentëve do t'u mundësojë të pajisen me informacione të duhura për funksionimin e shoqërisë pluraliste. Nëpërmjet të kësaj lënde studentët do të informohen më për së afërmi me thelbin e partive politike dhe me ndikimin e tyre në sistemet politike bashkëkohore, me marrëdhëniet në mes të partive politike dhe demokracisë bashkëkohore si dhe për shumë faktorë të tjerë të cilët e përcaktojnë jetën shoqëro-politike bashkëkohore.

- **Zhvillimi profesional i karrierës**

Mundësitë e përshkruara të karrierës janë të dizajnuara për t'i orientuar studentët në parashikimin fillestar për punë

pas diplomimit që më vonë mund të çojë në një karrierë të ndryshme profesionale. Kjo është lëndë për planifikim strategjik të karrierës e jo vetëm kurs se "si të gjejë punë". Lënda Zhvillimi profesional i karrierës është projektuar për të inkurajuar procesin e planifikimit të hershëm dhe zhvillimit të karrierës. Procesi përfshin vetëanalizim të thellë, eksplorim të karrierës, planifikim dhe mbikëqyrje të strategjive paraprake për punësim, etj. Filozofia e lëndës është që ky proces është i vazhdueshëm, sistematik dhe ka për qëllim një jetë të plotësuar me punë që është pjesë e planit të përgjithshëm për zhvillim profesional. Angazhimi në këtë proces duhet të jetë sfidues, interesant dhe ju të jeni të kënaqur. Pëparësitë që kjo lëndë i ofron do t'ju ndihmojnë gjatë kalimit nga studenti në punonjës dhe do t'ju ndihmojnë të vendosni një rrugë më të drejtëpërdrejtë për të përmbushur objektivat tuaja afatgjata të karrierës nëpërmjet parashikimit dhe mësimin të aftësive të nevojshme, kurseve dhe përvojës për punën fillestare e cila do të jetë pika më e mirë e fillimit të karrierës që ju planifikoni.

- **Bazat dhe parimet e kontabilitetit**

Qëllimi i programit të lëndës është që studentët të kuptojnë thelbin e kontabilitetit, të mësojnë bazat e kontabilitetit financiar dhe konceptet dhe parimet e kontabilitetit.

- **Problemet politike të integritimit në BE**

Proceset e zgjerimit të BE dhe integrimi në sistemin juridik-politik dhe strukturat institucionale të Bashkimit Evropian; zhvillimi i tyre historik, struktura ligjore e mekanizmave për zgjerimin në kuadër të marrëveshjeve të BE si dhe çështja politike që i ndjek këto procese-kushtëzimi i tyre gjeopolitik dhe gjeokulturor, si dhe kushtëzimi në aspektin e interesave nacionale të vendeve anëtare të BE-së dhe të vendeve që aspirojnë.

- **Hapësira administrative Evropiane**

Kjo lëndë ka të bëjë me zhvillimin e një sistemi të së drejtës administrative në BE dhe përqendrohet në dy pyetje të ndara por edhe të ndërlidhura: evropianizimi i së drejtës administrative dhe parimet e së drejtës administrative. Kjo lëndë ka për qëllim tu mësojë studentëve parimet themelore lidhur me punën në administratën e BE-së dhe për t'i njoftuar me nevojën për transpozimin e tyre në nivel nacional në administratën shtetërore. Në veçanti, ato do të zotërojnë rregullat më të përshtatshme dhe më efektive për punën e administratës, pëparësitë e tyre, por edhe të mendojnë në mënyrë kritike rreth devijimeve që ekzistojnë në administratën publike të vendit. Kjo është rezultat i nevojës për punë në administratë sipas rregullave të miratuara nga shtetet me demokraci perëndimore.

- **Etika në administratën publike**

Qëllimet e planprogramit të lëndës (kompetencat): * Të ketë njohuri dhe të kuptojë semantikën dhe konceptet e moralit e të etikës, standardet e sjelljes, arësyetimin moral dhe filozofinë morale. * Të zhvillojë qëndrim për pozitën e moralit në jetën profesionale. * Të formojë qëndrime të qarta për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në administratën publike dhe atë shtetërore. * Të ketë aftësi për t'u ballafaquar me situata problematike etike. * Ta ketë ndjenjën e karakterit të nevojshëm në profesionin e administratorit. * Të njihet me literaturë për etikën në sferën e administrimit publik. * Të ketë gatishmëri për të përdorur mjete të komunikimit dhe të respektojë standardet etike në punën në institucionet shtetërore dhe aktorëve publikë.

- **Të drejtat e njeriut dhe roli i shërbimeve publike**

Qëllimet e planprogramit të lëndës (kompetencat): * Roli dhe rëndësia e të drejtave të njeriut si vlerë thelbësore dhe atribut i njeriut apo qytetarëve si dhe vlerë themelore të demokracisë dhe regjimeve demokratike dhe një nga elementet më themelore të shtetit juridik.

- **Teoritë e sjelljes organizative**

Përmes kësaj lënde studentët do të njoftohen me strukturat dhe me funksionet e organizatave në sektorin publik dhe jofitimprurës dhe me sjelljen e njerëzve në këto organizata. Studentët nëpërmes kësaj lënde fillimisht do të mund të kuptojnë konceptet e organizimit dhe teknikat praktike për menaxhimin e organizatave në rrethana të ndryshme. Në fund të semestrit studentët duhet të kenë njohuri në fushat e mëposhtme: * Teoritë themelore dhe relevante në organizatat në sektorin publik, * Menaxhimi i personelit, * Shkathtësi për punë në grupe.